



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 tetor 2024
Nr. ref.:RK 2565/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI108/24

Parashtrues

Bekim Fazliu dhe Rrahman Fazliu

**Vlerësimin i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Pml. nr. 61/2024 të 29 shkurtit
2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Bekim Fazliu dhe Rrahman Fazliu, me vendbanim në Komunën e Lipjanit, që përfaqësohen nga Nebih Troshupa dhe Fitore Troshupa, avokat nga Komuna e Lipjanit, respektivisht nga Komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 61/2024] të 29 shkurtit 2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [APS. nr. 33/2023] e 22 shtatorit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P. nr. 335/12] e 21 qershorit 2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Vendimin e kontestuar parashtruesit e kërkesës e kanë pranuar më 4 prill 2024.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara, përmes së cilave pretendohet se parashtruesve të kërkesës u janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet: 24 [Barazia Para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 7 maj 2024, parashtruesit e kërkesës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 maj 2024, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. GJR. KI108/24 caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese dhe anëtarët e Kolegjit shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Safet Hoxha dhe Radomir Laban (anëtarë).
8. Më 31 maj 2024, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe iu kërkoi atyre që brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të dorëzonin autorizimin specifik për përfaqësim në Gjykatë.
9. Më 13 qershor 2024, parashtruesit e kërkesës dorëzuan autorizimet specifike për përfaqësim në Gjykatë.
10. Më 26 qershor 2024, Gjykata i parashtrroi kërkesë Gjykatës Themelore për dorëzimin e dosjes së plotë të lëndës.
11. Më 28 qershor 2024, Gjykata pranoi dosjen e plotë të lëndës nga Gjykata Themelore.
12. Më 2 korrik 2024, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

13. Më 1 tetor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtare raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 12 maj 2011, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PSRK) ngriti aktakuzë [PPS. nr. 31/10] kundër parashtruesve të kërkesës, për shkak të veprave penale: (i) Shpërlarja e parave nga neni 32, paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji nr. 03/L-196), për periudhën kohore nga 1 korriku 2002 deri më 15 dhjetor 2010; (ii) Kontrabandim i Mallrave nga neni 273, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK); (iii) Shmangie nga Tatimi nga neni 249, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së; dhe (iv) Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236, paragrafi 1 të KPRK-së.
15. Më 4 dhjetor 2020 dhe 16 dhjetor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [P. nr. 335/12] hodhi pjesërisht aktakuzën ndaj parashtruesve të kërkesës në lidhje me veprat penale: (i) Kontrabandim i Mallrave nga neni 273, paragrafi 1 i KPRK-së; (ii) Shmangie nga Tatimi nga neni 249, paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së; dhe (iii) Keqpërdorim i autorizimeve në ekonomi nga neni 236, paragrafi 1 të KPRK-së, për shkak të parashkrimit absolut të veprave penale. Ndërsa u vazhdua procedura penale në lidhje me veprën penale – Shpërlarja e parave në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi nga neni 32, paragrafi 2 i Ligjit nr. 03/L-196 lidhur me nenin 31 dhe nenin 77 të KPRK-së.
16. Më 21 qershor 2023, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 335/12] i shpalli fajtorë parashtruesit e kërkesës për veprën penale – Shpërlarja e parave në bashkëkryerje në kundërshtim të nenit 32, paragrafit 2 të Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së; dhe ia shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimin me gjobë prej 10.000.00 (dhjetë mijë) euro, secilit veç e veç. Gjykata Themelore arsyetoi se, parashtruesit e kërkesës kishin pranuar në llogaritë e tyre bankare shumë të larta të parave nga personi S.P., të cilat pastaj i kishin transferuar në Kinë. Gjykata Themelore theksoi se parashtruesit e kërkesës është dashur ta dinë që paratë e pranuar nga S.P., kishin origjinë nga aktiviteti kriminal dhe nuk kishin mbulesë ligjore.
17. Parashtruesit e kërkesës dorëzuan ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penal.
18. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore ankesë paraqiti edhe Prokurori i Prokurorisë Speciale, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që parashtruesve të kërkesës t’iu shqiptoj dënim më të lartë.
19. Më 22 shtator 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [APS. nr. 33/2023] i refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesve të kërkesës dhe të Prokurorit të Prokurorisë Speciale, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Gjykata e Apelit arsyetoi se të gjitha provat që ishin administruar nga Gjykata Themelore dëshmuan që parashtruesit e kërkesës kishin marrë para nga S. P. dhe i kishin deponuar në llogaritë bankare të bizneseve të tyre, me të cilat kishin blerë mallra në Kinë për biznesin e S. P. Kjo u vërtetua nga ekspertiza financiare dhe transferet e parave nga llogaritë bankare. Gjykata e Apelit u pajtua me arsyetimin e Gjykatës Themelore se parashtruesit e kërkesës është

dashur ta dinë që S.P. kishte për qëllim aktivitetin e jashtëligjshëm dhe pastrimin e parave, për shkak se kishin përvojë me menaxhimin e bizneseve të tyre dhe se shumat e parave që i kishin pranuar nga ai ishin shumë të larta. Në këtë mënyrë, parashtruesit e kërkesës përmes transfereve bankare ia kanë mundësuar S. P. legjitimitetin e parave të kundërligjshme.

20. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit. Parashtruesit e kërkesës pretenduan para Gjykatës Supreme se vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit: (i) nuk kishin bërë vlerësimin e saktë të provave në lidhje me vërtetimin e ekzistimit të veprave penale dhe përgjegjësisë së tyre penale; (ii) nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë faktet të cilat janë konsideruar si të vërtetuara; (iii) vendimet nuk janë bazuar në provat e administruara gjatë procesit gjyqësor.
21. Më 29 shkurt 2024, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 61/2024] i refuzoi kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesve të kërkesës kundër aktgjykimeve të lartcekura. Gjykata Supreme me atë rast theksoi se Gjykata Themelore me prova të mjaftueshme i shpalli fajtorë parashtruesit e kërkesës dhe vërtetoi që kishin kryer veprën penale, përfshirë dëshmitarët, ekspertin financiar dhe prova të tjera materiale. Gjykata Supreme konstatoi se veprimet e parashtruesve të kërkesës i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprës penale për të cilën u shpallën fajtorë.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

22. Parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestojnë Aktgjykimin [PML. nr. 61/2024] e 29 shkurtit 2024 të Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin [APS. nr. 33/2023] e 22 shtatorit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P. nr. 335/12] e 21 qershorit 2023 të Gjykatës Themelore, duke pretenduar se me aktgjykimet e kontestuar atyre u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 24 [Barazia Para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së.

(i) pretendimet për shkeljen e nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës

23. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se gjykatat e rregullta i trajtuan në mënyrë të pabarabartë në raport me personin tjetër të akuzuar. Personi i tretë, i cili kishte bërë pagesa përmes llogarive bankare, u akuza për vepra penale të cilat u hodhën poshtë për shkak të parashkrimit dhe nuk kishte akuzë për shpërlarje të parave.
24. Parashtruesit e kërkesës specifikisht theksojnë që: *“Në kërkimin e drejtësisë procedurale, konsistenca është një kriter qendror i cili zbatohet përgjatë kohës dhe ndërmjet personave, që do të thotë se procedura të ngjashme duhet të zbatohen për të gjithë në mënyrë të njëjtë dhe të paktën të mbeten të qëndrueshme në afat të shkurtër kohor”*. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se ndjekja penale selektive dhe abstenimi nga ndjekja penale në rastet kur ka ndodhur vepra penale, është në kundërshtim me parimin e legalitetit.
25. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se: *“Është më se evidente se në një numër të konsiderueshëm të raporteve ndërkombëtare si Raporti i Progresit i BE por edhe raporte të tjera të mekanizmave ndërkombëtar, sistemi gjyqësor është kritikuar për numër të vogël të rasteve të vendosura nga gjykatat lidhur me shpërlarjen e parave dhe atyre të korrupsionit”*. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se *“për të ndryshuar vlerësimin në këto raporte gjykatat kanë tentuar me çdo kusht të provojnë të gjykojnë raste të cilat edhe pse do të mund të rrëzohen më vonë, por me qëllim të*

ndryshimit të perceptimit të publikut mbi punën e gjykatave në këtë fushë”. Prandaj sipas parashtruesve të kërkesës “ishte marrë vendim intern në gjykata që çështjet e shpërlarjes së parave të korrupsionit dhe terrorizmit të shenjtëroheshin dhe ato mbanin një regjistrim intern me akronim L.V. që nënkuptonte liberalizim i vizave”.

26. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë: *“Në një situatë të tillë gjykatat nuk kanë qenë të pavarura dhe të paanshme nga reagimi i organizatave ndërkombëtare dhe kanë dështuar në garantimin e këtij standardi në çështjen në fjalë, duke cenuar të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me Kushtetutë”.*
27. Parashtruesit e kërkesës theksojnë gjithashtu se është shkelur e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, për shkak se procesi gjyqësor në këtë rast zgjati pothuajse katërmëdhjetë (14) vite, duke shkelur të drejtën për një proces gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm.

(i) pretendimet për shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNj-së

28. Sa i përket pretendimeve për shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNj-së, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimet e gjykatave të rregullta, respektivisht Aktgjykimi [P. nr. 335/12] i 21 qershorit 2023, i Gjykatës Themelore; Aktgjykimi [APS. nr. 33/2023] i 22 shtatorit 2023, i Gjykatës së Apelit; dhe Aktgjykimi [Pml. nr. 61/2024] i 29 shkurtit 2024, i Gjykatës Supreme, shkelën parimin e legalitetit dhe proporcionalitetit, sepse: (i) gjykatat e rregullta u mbështetën në Ligjin nr. 03\L-196 i cili është shpallur në Gazetën Zyrtare më 9 nëntor 2010, ndërsa ata u akuzuan për veprimet që ndodhën nga 1 korriku 2002 deri më 15 dhjetor 2010, pra një periudhë që ligji i lartcekur e mbulon për rreth 1 muaj e 6 ditë; (ii) ligji nuk mund të ketë efekt retroaktiv dhe gjykatat e rregullta nuk e kanë sqaruar se aktiviteti për të cilin është dhënë dënimi për periudhën kohore 1 korrik 2002-15 dhjetor 2010, sidomos periudha prej 1 muaji e 6 ditëve të hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 03\L-196, ka të bëjë me veprat penale për të cilat me aktvendim është hedhur poshtë pjesa e aktakuzës, për shkak të parashkrimit absolut apo gjatë kësaj periudhe ka pasur veprime të cilat mbulohen ekskluzivisht me Ligjin nr. 03\L-196; (iii) parashikueshmërisë së ligjit që kërkon që ligji të jetë i qasshëm dhe gjithashtu të ekzistojnë masa mbrojtëse gjyqësore aty ku autoritetet kombëtare kanë kompetenca të gjera diskrecionale.
29. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se në bazë të aktakuzës fillestare të PSRK-së ata akuzoheshin edhe për tre vepra të tjera penale, të cilat i hodhi poshtë Gjykata Themelore për shkak të parashkrimit absolut. Mirëpo, gjykatat e rregullta nuk e sqaruan faktin se veprimet e tyre lidheshin me veprat penale për të cilat ata u liruan nga aktakuza. Sipas parashtruesve të kërkesës, aktgjykimet e gjykatave të rregullta nuk kanë arritur të bëjnë ndërlidhjen midis çfarëdo aktivitetit kriminal dhe veprimeve të tyre dhe nuk kanë vërtetuar ekzistimin e veprës penale.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS **Neni 31** **[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

- 1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
- 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

[...]

Neni 33

[Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale]

1. Askush nuk mund të akuzohet ose të dënohet për asnjë veprë e cila, në momentin e kryerjes, nuk ka qenë e përcaktuar me ligj si veprë penale, me përjashtim të veprave të cilat, në kohën e kryerjes së tyre, sipas së drejtës ndërkombëtare, përbënin gjenocid, krime lufte ose krime kundër njerëzimit.
2. Dënimi i shqiptuar për një veprë penale nuk mund të jetë më i ashpër sesa ka qenë i përcaktuar me ligj në kohën e kryerjes së veprës.
3. Ashpërsia e dënimit nuk mund të jetë në disproporcion me veprën penale.
4. Dënimet përcaktohen në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, me përjashtim të veprave për të cilat ligji i mëvonshëm i aplikueshëm është më i favorshëm për kryesin e veprës.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohej shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë.

NENI 7

(Nuk ka dënim pa ligj)

1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer, nuk përbënte veprë penale sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

KODI NR. 06/L-074 KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS BASHKËPUNIMI NË KRYERJEN E VEPRËS PENALE

Neni 31

Bashkëkryerja

Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprë penale.

Neni 77

Dënimi për veprat penale në vazhdim

1. Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim:

1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale;

1.2. objekti i njëjtë i veprës;

1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore;

1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; ose

1.5. dashja e njëjtë e kryesit.

[...]

Neni 302 **Shpërlarja e parave**

Kushdo që kryen vepër penale të shpërlarjes së parave, dënohet sipas Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit.

LIGJI Nr. 03/L-196 PËR PARANDALIMIN E SHPËRLARJES SË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Neni 32 **Veprat penale**

[...]

Shpërlarja e parave

2.

Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës:

[...]

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

32. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47 dhe 48 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49

(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

33. Në mënyrë që të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës para Gjykatës kontestojnë Aktgjykimin [PML nr. 61/2024] të 29 shkurtit 2024, të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [APS nr. 33/2023] e 22 shtatorit 2023, të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P nr. 335/12] e 21 qershorit 2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke pretenduar se me vendimet e kontestuar atyre u janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet: 24 [Barazia Para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së.
34. Në vijim, Gjykata do të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë (i) përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me nenet 24 dhe 31 të Kushtetutës, dhe më pas do të vlerësojë përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë (ii) përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me nenin 33 të Kushtetutës lidhur me nenin 7 të KEDNJ-së.
- (i) *përkitazi me përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës, në lidhje me pretendimet për shkeljet e nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës.*
35. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura të pranueshmërisë së kërkesës, në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml nr. 61/2024] e Gjykatës Supreme, të 29 shkurtit 2024, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; kanë specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendojnë se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e kanë parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
36. Gjykata i referohet rregullit 34 (Kriteret e pranueshmërisë) (1) (d) dhe (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

*"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
[...]"*

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

37. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Pretendimet qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, bazuar në praktikën gjyqësore, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e Gjykatës, (i) KI40/20, parashtrues Sadik Gashi, cituar më lart, i 20 janarit 2021; (ii) [KI163/18](#), parashtrues Kujtim Lleshi, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; (iii) [KI21/21](#), parashtrues, Asllan Meka, Aktvendim për papranueshmëri, i 28 prillit 2021; dhe (iv) [KI107/21](#), parashtrues Ramiz Hoti, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021.
38. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, me argumentin se personi tjetër S.P., nuk u akuzua për veprën penale të shpërlarjes së parave dhe u trajtua ndryshe në raport me ata.
39. Lidhur me pretendimin se parashtruesit e kërkesës janë diskriminuar kundrejt palëve të treta në këtë rast personit S.P., sepse personi në fjalë “nuk u akuzua për veprën penale të shpërlarjes së parave dhe u trajtua ndryshe në raport me ata”, Gjykata vlerëson se nevojiten shkaqe me peshë (*weighty reasons*) për të vlerësuar rastin e parashtruesve të kërkesës kundrejt procedurave që janë zhvilluar (ose nuk janë zhvilluar) lidhur me palët e treta për shkak se një vlerësim i tillë del jashtë fushëveprimit të kësaj kërkesë individuale kushtetuese dhe se në rrethanat e rastit konkret mungojnë shkaqet me peshë (shih *mutatis mutandis* rastet e Gjykatës [KI107/22](#) parashtrues Valdet Avdiu, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 janarit 2023, paragrafi 47; dhe [KI59/23](#) parashtrues Fehmi Grajçevci, Aktvendim për papranueshmëri, i 30 gushtit 2023, paragrafi 55).
40. Gjithashtu, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, duke theksuar se: “është më se evidente se në një numër të konsiderueshëm të raporteve ndërkombëtare si Raporti i Progresit i BE por edhe raporte të tjera të mekanizmave ndërkombëtar, sistemi gjyqësor është kritikuar për numër të vogël të rasteve të vendosura nga gjykatat lidhur me shpërlarjen e parave dhe atyre të korrupsionit”. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu theksojnë se “për të ndryshuar vlerësimin në këto raporte gjykatat kanë tentuar me çdo kusht të provojnë të gjykojnë raste të cilat edhe pse do të mund të rrëzohen më vonë, por me qëllim të ndryshimit të perceptimit të publikut mbi punën e gjykatave në këtë fushë”. Prandaj sipas parashtruesve të kërkesës “ishte marrë vendim intern në gjykata që çështjet e shpërlarjes së parave të korrupsionit dhe terrorizmit të shenjtëroheshin dhe ato mbanin një regjistrim intern me akronim L.V. që nënkuptonte liberalizim i vizave.” Parashtruesit e kërkesës theksojnë gjithashtu se procesi gjyqësor zgjati për shumë vite, duke shkelur të drejtën për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor.
41. Në rastin konkret, Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesës vetëm i kanë ngritur këto pretendime, por nuk ofrojnë argumente kushtetuese për t’i mbështetur këto pretendime.

42. Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës, i përkasin pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara”, prandaj Gjykata i shpall si qartazi të pabazuara, sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.

(ii) përkritazi me përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës, në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës dhe nenit 7 të KEDNJ-së.

43. Përkritazi me përmbushjen e kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës, në lidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, Gjykata vlerëson se parashtruesit e kërkesës janë palë e autorizuar, në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 61/2024] e Gjykatës Supreme, të 29 shkurtit 2024, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion në aspektin formal, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; kanë specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendojnë se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e kanë parashtruar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
44. Megjithatë, Gjykata rithekson që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, në ndërlidhje me paragrafin 2 i nenit 47 të Ligjit dhe pika (b) e paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës, ndër të tjera, qartë përcaktojnë detyrimin e "shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj", në të dy aspektet, atë formal dhe substancial, me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.
45. Kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur, janë të përcaktuara në praktikën e GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, Gjykata bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
46. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në "substancë" para gjykatave të rregullta që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dyja kuptimet (shih, rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), parashtrues Kamer Borovci, Mustafi Borovci dhe Avdulla Bajra, cituar më lart, paragrafi 57; [KI119/17](#), parashtrues Gentian Rexhepi, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2019, paragrafi 73).
47. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata në vijim duhet të vlerësojë nëse përtej shterimit të mjeteve juridike në aspektin formal e që është rasti në rrethanat e rastit konkret, janë shteruar mjetet juridike edhe në kuptim substancial, përkatësisht nëse pretendimet e parashtruesve të kërkesës, në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së të paktën në substancë, janë ngritur edhe para gjykatave të rregullta.
48. Gjykata rithekson që thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesës në lidhje me të drejtat e garantuara me nenin 33 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 7 të KEDNJ-së ndërlidhet me pretendimin që vendimet e gjykatave të rregullta shkelën parimin e

legalitetit dhe të proporcionalitetit për shkak se: (i) vendimet e gjykatave të rregullta u bazuan në Ligjin nr. 03/L-196 i cili aplikohej ndaj veprimeve të kryera për vetëm 1 muaj e 6 ditë; (ii) ligji nuk mund të kishte efekt retroaktiv; dhe (iii) ligji nuk ishte i parashikueshëm.

49. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Themelore hodhi poshtë pjesërisht aktakuzën e PSRK-së (për tri vepra penale) ndaj parashtruesve të kërkesës për shkak të parashkrimit absolut ndërsa e vazhdoi procedurën penale në lidhje me akuzën për veprën penale “Shpërlarja e parave” në bashkëkryerje dhe në vazhdimësi, sipas paragrafit 2, të nenit 32 të Ligjit nr. 03/L-196 në lidhje me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së. Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P. nr. 335/12] i shpalli fajtorë parashtruesit e kërkesës për veprën e lartcekur penale dhe ua shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimin me gjobë prej 10.000.00 (dhjetë mijë) euro, secilit veç e veç.
50. Parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore për arsye se sipas parashtruesve të kërkesës, Gjykata Themelore përmes aktgjykimit [P. nr. 335/12] me të cilin ishin shpallur fajtorë dhe ishin dënuar me dënimin e lartcekur, nuk kishte arritur të vërtetojnë përgjegjësinë e tyre penale për kryerjen e veprës penale për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Parashtruesit e kërkesës pretenduan se ekspertiza financiare nuk vërtetoi kryerjen e veprës penale të shpërlarjes së parave. Po ashtu, ata paraqitën pretendime ankimore edhe në lidhje me shkeljen e ligjit penal sa i përket matjes së dënimit dhe rrethanave të tjera që lidheshin me kryerjen e veprës penale. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk ngritën pretendime për cenimin e parimit të legalitetit dhe të proporcionalitetit, dhe as pretendime për çështjen e zbatimit të ligjit në mënyrë retroaktive të Ligjit nr. 03/L-196, si dhe nuk ngritën pretendime për cenimin e parashikueshmerisë të po të njëjtit ligj.
51. Gjykata rikujton arsyetimin e Gjykatës së Apelit, e cila në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [P. nr. 335/12] kishte theksuar se Gjykata Themelore vërtetoi në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe mbi bazën e provave dhe fakteve kishte dëshmuar veprimet inkriminuese të parashtruesve të kërkesës. Gjykata e Apelit arsyetoi se Gjykata Themelore konstatoi në mënyrë të drejtë dhe të bazuar në prova që parashtruesit e kërkesës ishin penalisht përgjegjës për veprën penale për të cilën u shpallën fajtorë dhe se dënimi i shqiptuar ishte në përputhje me ligjin penal.
52. Parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe pretenduan se provat e administruara nuk treguan që ata e kishin kryer veprën penale. Ata theksuan po ashtu se vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit: (i) nuk e vërtetuan në mënyrë të saktë gjendjen faktike; (ii) nuk i vlerësuan provat në mënyrë të drejtë; (iii) nuk i vlerësuan drejtë dëshmitë e dëshmitarëve dhe ekspertizën profesionale. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk e kishin ngritur para Gjykatës Supreme pretendimin për shkeljen e parimit të legalitetit në procedurën penale dhe të zbatimit retroaktiv të Ligjit nr. 03/L-196, dhe as pretendimin për parashikueshmerinë e ligjit në fjalë.
53. Gjykata vëren që, në arsyetimin e vendimit për hedhjen poshtë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme theksoi se Gjykata Themelore kishte ofruar arsye të mjaftueshme të mbështetura në prova në lidhje me dënimin e parashtruesve të kërkesës dhe i kishte paraqitur në mënyrë të qartë faktet kontestuese dhe jokontestuese. Gjykata Supreme gjithashtu arsyetoi se, Gjykata Themelore e bazoi aktgjykimin e saj vetëm në provat të cilat i kishte administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe kishte

provuar përgjegjësinë penale të parashtruesve të kërkesës në lidhje me veprën penale për të cilën u shpallën fajtorë.

54. Bazuar në si më lart, Gjykata thekson se parashtruesit e kërkesës në asnjë instancë të gjykatave të rregullta nuk e kontestuan zbatimin e Ligjit nr. 03/L-196, që shërbeu si bazë ligjore për shqiptimin e dënimit; dhe as nuk pretenduan që Ligji nr. 03/L-196 ishte zbatuar në mënyrë retroaktive në dëm të tyre. Ata ngritën pretendime të tjera ankimore, në lidhje me fajësinë e tyre dhe vlerësimin e gabuar të provave gjatë procesit gjyqësor. Parashtruesit e kërkesës për herë të parë pretendimet e tilla i ngrenë para Gjykatës dhe theksojnë që, Ligji nr. 03/L-196 hyri në fuqi vetëm 1 (një) muaj para se të përfundonin veprimet e tyre të jashtëligjshme në lidhje me shpërlarjen e parave dhe që gjykatat e rregullta e zbatuan në mënyrë retroaktive ligjin në fjalë.
55. Marrë parasysh rrethanat në të cilat sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesve të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesit e kërkesës nuk ua dhanë mundësinë gjykatave të rregullta, përfshirë Gjykatën e Apelit dhe atë Supreme, të adresojnë këto pretendime dhe me këtë rast të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesit e kërkesës i ngritin drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial.
56. Gjykata rithekson se parashtruesit e kërkesës detyrohen që të shterojnë të gjitha mjetet juridike jo vetëm në kuptimin formal, por edhe atë substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese “në substancë/përmbajtje” para gjykatave të rregullta, në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut. Gjykata nuk i shqyrton pretendimet e parashtruesit të kërkesës, nëse ato nuk janë ngritur paraprakisht pranë gjykatave të rregullta as formalisht dhe as në përmbajtje (shih, rastet e Gjykatës, KI155/18, parashtrues Benson Buza, Aktvendim për papranueshmëri i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50; KI163/18, *parashtrues Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri i 24 qershorit 2020, paragrafi 59).
57. Përveç kësaj, GJEDNJ - ja mban qëndrimin se mjeti juridik duhet të shfrytëzohet, për aq sa ekziston një mjet i tillë që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë të paktën në substancë argumentin për shkelje të një të drejte. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur pranë gjykatave të rregullta, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, kur ka mundur të ngrihet nga parashtruesi i kërkesës gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi kjo të cilën synon ta ofrojë rregulli për shterimin e mjeteve juridike (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; shih, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafi 72).
58. Gjykata thekson se, përderisa në kontekstin e makinerisë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, rregulli për shterimin e mjeteve juridike duhet të aplikohet me "një" shkallë fleksibiliteti dhe pa ndonjë formalizëm të tepruar", ky rregull në parim kërkon që ankesat dhe pretendimet që synohen të ngrihen më vonë në proces gjyqësor, duhet të jenë ngritur edhe para gjykatave të rregullta, të paktën në substancë dhe në respektim të kushteve formale dhe afateve të përcaktuara përmes ligjit të aplikueshëm, (shih, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesat 2478/15 dhe 1787/15, Aktgjykim i 16 korrikut 2015, paragrafi 89 dhe referencat e përfshira aty; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI119/17, parashtrues *Gentian Rexhepi*, cituar më lart, paragrafi 71).

59. Respektimi i parimit të subsidiaritetit kërkon pikërisht lejimin e mundësisë dhe hapësirës së nevojshme për gjykatat e instancave më të ulëta që ta kryejnë detyrën e tyre për zbatim të drejtpërdrejtë të Kushtetutës dhe KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin formal (shih, ndër të tjera, parimet e përgjithshme përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në rastet e Gjykatës, [KI219/21](#), parashtues *Isuf Ferati*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 korrikut 2022, paragrafët 26 dhe 28; [KI193/20](#), parashtues *Bujar Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 majit 2021, paragrafët 26-28). Por, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ajo gjithashtu ka ndërtuar praktikën gjyqësore përkitazi me shterimin e mjeteve juridike në kuptimin substancial (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), parashtues *Kamer Borovci, Mustafi Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafi 57; [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 94).
60. Bazuar në si më lart, Gjykata thekson se në rastin konkret, parashtuesit e kërkesës nuk i kishin ngritur pretendimet e tyre për shkeljen e parimit të legalitetit dhe zbatimit retroaktiv të ligjit në procedurën penale para gjykatave të rregullta dhe nuk i dhanë mundësinë gjykatave të rregullta të adresonin pretendimet e tyre. Këto pretendime për herë të parë i ngritën para Gjykatës.
61. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtuesve të kërkesës për shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, përkitazi me zbatimin retroaktiv të ligjit, shpallen të papranueshme në baza procedurale për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike në kuptimin substancial, siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafit 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

Përfundim

62. Në pajtueshmëri me arsyetimin e këtij aktvendimi, Gjykata thekson se pretendimet e parashtuesve të kërkesës për shkeljen e nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës, i përkasin pretendimeve "*të pambështetura apo të paarsyetuara*", prandaj Gjykata i shpall si qartazi të pabazuara, sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës.
63. Përderisa pretendimet në lidhje me shkeljen e nenit 33 të Kushtetutës në lidhje me nenin 7 të KEDNJ-së, respektivisht pretendimet për shkeljen e parimit të legalitetit dhe të proporcionalitetit të garantuar me nenin 33 të Kushtetutës, për shkak se: (i) vendimet e gjykatave të rregullta u bazuan në Ligjin nr. 03/L-196 i cili aplikohet ndaj veprimeve të kryera për vetëm 1 muaj e 6 ditë; (ii) ligji nuk mund të kishte efekt retroaktiv; dhe (iii) ligji nuk ishte i parashikueshëm, e të cilat pretendime refuzohen si të papranueshme në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të mjeteve juridike dhe rrjedhimisht nuk i përmbushin kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 34 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

64. Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 34 (1) (b) dhe (2) të Rregullores së punës, më 1 tetor 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese


Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani